



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

## KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 06-23982/23

Klinë, datë: 20.07, 2023

### PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Gllarevë, i cili u mbajt në sallën e sporteve "JETONI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Caravik, Rixhevë dhe Stapanicë. Tubimi u mbajt me datë 15 qershor 2023 dhe filloi në orën 18:30, ku morën pjesë: 11 persona.

### RENDI I DITES

#### 1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave ka bërë një prezantim për shifrat që do të këtë buxheti për vitin 2024. Sipas tij buxheti për vitin 2024 do të jetë rreth 15 milion euro. Rreth 50% të buxhetit do të shkojnë për kategorinë paga dhe mëditje, ku janë parapare rreth 8 milion euro. Komuna e Klinës ka paraparë që të shpenzoj 4.5 milion euro për investimet kapitale, për mallra dhe shërbime do të shpenzohen rreth 2 milion euro. Në pika të shkurtëra drejtori Berisha foli edhe projektet e planifikuara infrastrukturore.

Pas drejtorit Berisha, fjalën e mori edhe kryetari Elezaj, ku para banorëve të këtyre lokaliteteve, theksoi projektet investive që pritet të realizohen në fshatin Gllarevë është kanalizimi si dhe disa rrugë lokale.

Kryetari Elezaj gjatë këtyre takimeve theksoi se përfshirja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, siç është Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, ndikojnë drejtpërsëdrejti në kualitetin e jetës së qytetarëve duke filluar nga ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, shkollave dhe qendrave të mjekësisë familjare, ashtu siç ata i shohin të arsyeshme nevojat e zonave ku banojnë.

## DISKUTIMET DHE KËRKESAT

**Xhevdet Balaj - Fshati Gllarevë**, filloi takimin duke përshëndetur të pranishmit e më pas kërkoi nga drejtori i Financave, z. Enver Berisha të informoj të pranishmit se sa është shuma e cila është planifikuar të investohet në fshatin Gllarevë. Ndërsa kërkesë e tij ishte që të ndërtohet rrjeti i kanalizimit në një pjesë të fshatit.

**Kryetari Elezaj**, duke ju përgjigjur z.Balaj, informoi të pranishmit se brenda këtij viti, tanimë veç janë në procedurë të prokurimit publik për fshatin Gllarevë janë parapa në kontratë afër 56 mijë euro investime.

**Tafil Morina, lagjja “Manaj” – Fshati Gllarevë**, kërkon të rregullohet një prerje e asfaltit nga ndërtimi i kanalizimit, rruga ka filluar të shembet për shkak të prerjes.

**Kryetari Elezaj** pasi ishte i pranishëm ju përgjigj z. Morina, pasi që drejtorja e Shërbimeve Publike ka kontratë aktive në mirëmbajtjen e rrugëve dhe rregullimin e tyre, shumë shpejtë ky problem, këto prerje në rrugët e lagjes “Manaj” do të rregullohen.



**Alban Balaj – Fshati Gllarevë**, para të pranishmeve parashtrori si kërkesë asfaltimin e rrugës që shpie te shtëpia e tij.

**Fadil Bashota – Fshati Carravik**, kërkon që tri rrugët e lagjes së tij të asfaltohen: rruga “17 shkurti”, rruga “Hisen Bashota” dhe rruga e tretë degëzim nga rruga e dytë, për në Stapanicë. Po ashtu, kërkon një fushë të futbollit dhe gjelbërim të hapësirave publike, dhe shpreh vullnetin që me fonde vetanake të punojë hapësirat publike.

Gjithashtu, kërkon një trotuar për këmbësorë, përgjatë rrugës “17 Shkurti”. Ai këto kërkesa i parashtrroi si nevojat e tanishme të fshatit Carravik.

**Kryetari Elezaj**, i përgjigjet z. Bashota që këto kërkesa do të jenë prioritet në projeksione e viteve 2024-2026, të cilat nuk mund të realizohen aq shpejtë për shkak që në fshatin Carravik vetëm sa është përmyllur kontrata për asfaltim të rrugëve lokale, një investim prej afër 70 mijë euro, pothuajse janë përfshirë të gjitha rrugët në fshat. Gjithashtu, Elezaj theksoi faktin se shumë shpejtë hapësirat publike në fshatin Gllarevë do të pastrohen.

**Emin Balaj – Fshati Gllarevë**, kërkon të rregullohet ujësjellësi në fshatin Gllarevë.

**Kryetari Elezaj**, thkesoi se tashmë ujësjellësi në fshatin Gllarevë që po realizohet në bashkëpunim me CDI është drejt përfundimit, janë disa detaje të vogla që duhet të finalizohen e që janë kyqjet, testimi etj.

**Skender Veselaj – Fshati Gllarevë**, kërkon ndërtimin e një parku në fshatin Gllarevë.

**Kryetari Elezaj**, informoi z. Veselaj që parku në fshatin Gllarevë shumë shpejtë do të realizohet.

**Shaip Veselaj – Fshati Gllarevë**, Kërkon t`i asfaltohet rruga pranë shtëpive të tij në fshatin Gllarevë.



Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt në sallën e sporteve “JETONI”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Carravik, Rixhevë dhe Stapanicë, pjesëmarrës kanë qenë 11 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	11
Total:	11

Takimi përfundoi në orën 19:15.

Procesmbajtësi:  
Nikson Daka



Klinë, datë: 20.07.20